



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE SHKODËR
SEKTORI I PROGRAMEVE TE ZHVILLIMIT
ZYRA E BURIMEVE NJEREZORE

Shkoder, me 02/09/2014

Nr 1022 Prot

URDHËR
Nr 21, date 02.09.2014

Në zbatim të ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë,, Dispozitive Normative të vitit 2013 të ndryshuara, si dhe akteve të tjera nënligjore të dalë në bazë dhe për zbatim të tyre, nisur edhe nga verifikimet e bera nga Zyra e Burimeve Njerëzore si dhe sugjerimet e MAS për përditësimin e vazhdueshëm të dosjeve të punonjësve definitiv,

URDHËROJ

- Përditësimin e dosjeve të të gjithë punonjësve mesimorë (mesues, drejtor, nëndrejtor, sekretare, psikolog) definitiv në shkollë.
- Përditësimi do të realizohet në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore Në Sektorin e Programeve të Zhvillimit, Drejtorin e Shkollës (ose një person të caktuar nga drejtori i shkollës)
- Të gjithë drejtorat e shkollave do të bëjnë mbledhjen e dokumentave të të gjithë mësuesve mbi bazën e një fletë inventari.
- Procesi i dorëzimit të dosjesve do të jetë me këto data :
- Shkollat 9-vjecare qytet nga data 22-09.2-14-26.09.2014
- Shkollat e mesme qytet në datat 29.09.14-30.09.14
- Shkollat 9-vjecare fshat nga data 01.10.2014-03.10.2014
- Shkollat e Mesme të Bashkuara nga data 08.10.2014-11.10.2014

Dokumentat të detyrueshme që do të ketë dosja janë:

- Të gjithë dokumentat shkollor, (të noterizuara)
dëftese pjekurie,
diplome (bachelor + master)
doktorature (nese ka)
- Gjithashtu në dosje do të ketë certifikatat e shkallëve të kualifikimit (minimalisht shkallën e fundit të noterizuar)
- Letren e emerimit të fundit në punë (nese ka pasur disa levizje)
- Fotokopje libreze pune.

- Cv sipas formatit te Bashkimit European.(tip europass)
- Vertetim i gjendjes shendetesore.
- Vetdeklarimin (Per verifikimin e gjendjes gjyqesore).
- Liçense per ushtrimin e profesionit te mesuesit (kane detyrim ligjor te diplomuarit pas shkurtit 2011, kopje e noterizuar)

Fakultative jane

- Certificate e gjuhes se huaj e mbrojtur (e noterizuar)
- Certificate kompjuteri (e noterizuar) .
- Botime (nese kane)
- Dëshmi me kredite (te noterizuara nese ka)
- Cdo dokument tjeter qe e cmon te arsyeshem (te noterizuar)
- Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Zyra e Burimeve Njerezore, dy specialistat e saj, drejtoret e shkollave, mesuesit definitiv.
- Mos zbatimi i urdherit ne kohe do të shoqerohet me masa per secilin punonjes i cili nuk e zbaton ose pengon zbatimin e tij.
- Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

V.o Ky urdher sebashku me Vetdeklarimin(Per verifikimin e gjendjes gjyqesore), formatin tip te CV sipas Europass, flete inventarin, do ti gjeni ne faqen zyrtare te DAR.

DREJTORE

ERJETA LAÇEJ (SINANI)

Konc.D.Shpuza

